

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

OTTO – AL Sh.p.k

31 Dhjetor 2013

Permbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	3
BILANCI KONTABËL	5
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	6
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	8
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	9

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin dhe aksionarët e

Otto-Al sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Otto-Al shpk (“Shoqëria”) që shoqerojnë këtë raport, bilancin kontabël më 31 Dhjetor 2013, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin ushtrimor, si dhe përmbledhjen e politikave kontabël dhe shpjegimeve të tjera, në faqet 5 deri 19.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe për kontrollin e brendshme deri në masën që drejtimi i konsideron të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë nga gabimet apo mashtrimet.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që në të zbatohet kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi në lidhje me shumatat dhe informacionet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e drejte të pasqyrave financiare në mënyre që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e cmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

TPA Horwath Albania

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 10 000 Tirana, Albania

www.tpa-horwath.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

Member of Crowe Horwath International (Zurich) – a worldwide association of separate an legally independent chartered accountants and consultants

Ne besojme që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme dhe shërben si bazë për opinionin tonë të kualifikuar të auditimit.

Bazat për Opinionin e Kualifikuar

Siç është paraqitur në Shënimin 4 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e llogarive të arketueshme është 53,487 mijë Lekë. Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim për mundësinë e arkëtimit të vlerës së llogarive të arketueshme dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

Siç është paraqitur në Shënimin 5 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e llogarive të tjera te drejta te arketueshme është 92,223 mijë Lekë. Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim për mundësinë e arkëtimit të vlerës prej 70,492 mijë dhe njohjen e humbjeve për borxhin e keq.

Siç është paraqitur në Shënimin 6 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2013 vlera e inventarit të Kompanisë është 198,816 mijë Lekë. Ne u angazhuam si auditues të Shoqërisë mbas datës 31 Dhjetor 31, 2013, dhe nuk kemi observuar numërimin e inventarit në fillim të vitit. Ne nuk ishim në gjendje të merrnim evidencë të mjaftueshme me anë të procedurave alternative në lidhje me sasinë e inventarit gjendje në 31 Dhjetor 2013 dhe koston e materialeve të konsumuar.


Opinion i Kualifikuar

Sipas opinionin tonë, përvec efekteve të çështjeve të diskutuara në paragrafin “Bazat për Opinionin e Kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2013, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2012 janë audituar nga një auditues tjetër i cili me datë 30 Qershor 2013 ka shprehur një opinion të kualifikuar (me rezerve) për këto pasqyra.

Tirana,
29 Korrik 2014


Ilir Binaj CPA, CGMA, EKF




Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2013
(në Lek)

Bilanci Kontabël

	Shënimet	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
AKTIVET			
Mjetet monetare	3	37,262,823	40,690,944
Llogari te arketueshme	4	53,487,355	164,640,757
Te tjera te drejta te arketueshme	5	92,223,079	90,645,697
Inventari	6	199,816,117	1,872,924
Punime në proces	7	-	359,318,887
Totali i aktiveve afatshkurtra		382,789,374	657,169,209
Aktive afatgjata materiale, neto	8	48,183,137	53,587,601
Investime ne shoqëri të tjera	9	6,300,000	6,300,000
Totali i aktiveve afatgjata		54,483,137	59,887,601
TOTALI I AKTIVEVE		437,272,511	717,056,810
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Furnitore	10	216,303,420	147,443,271
Detyrime ndaj punonjesve, sigurime etj	11	470,940	569,008
Te tjera te pagueshme	12	2,651,030	798,896
Parapagime të marra nga klientët	13	-	235,776,256
Totali i detyrimeve afatshkurtra		219,425,390	384,587,432
Detyrime per abonete		-	-
Huamarrje afat-gjate	14	-	102,631,606
Totali i detyrimeve afatgjata		-	102,631,606
Totali i detyrimeve		219,425,390	487,219,038
Kapitali i regjistruar		136,800,000	136,800,000
Rezerva te tjera		78,708,384	87,407,749
Fitimi i akumuluar		2,338,737	5,630,023
Totali i kapitalit	15	217,847,121	229,837,772
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		437,272,511	717,056,810

Pasqyrat financiare jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 25 Mars 2014 dhe firmosur ne emer te saj nga:


Nevila Kondili
Shef Finance

Isuf Berberi
Administrat



Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimet	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Te ardhura			
Te ardhura nga veprimtarite e shfrytezimit	16	28,887,466	71,913,954
Te ardhura te tjera	17	15,483,184	44,241,082
Totali I te ardhurave		44,370,650	116,155,036
Kostot operative			
Materialet e konsumuara	18	(26,191,511)	(72,241,645)
Shpenzime per personelin	19	(7,025,080)	(13,332,801)
Zhvleresim dhe amortizim	8	(2,297,849)	(6,190,012)
Shpenzime administrative dhe te tjera	20	(6,141,477)	(10,060,003)
Totali i shpenzimeve operative		(41,655,916)	(101,824,462)
Fitimi/(humbja) neto nga operacionet		2,714,734	14,330,574
Te ardhura (shpenzime) nga shitja e asetëve	21	-	(6,642,835)
Te ardhura (shpenzime) nga shitja e investimeve	22	-	(1,135,000)
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	23	17,180	199,054
Fitimi para tatimit		2,731,936	6,751,793
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	24	(393,199)	(1,121,770)
Fitim/(humbja) per vitin		2,338,737	5,630,023



Pasqyra e flukseve monetare

Shenime	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit		
Fitimi/(humbja) para tatimit	2,338,737	6,751,793
Rregullime per:		
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata material	8 2,297,849	6,190,012
Humbje (fitim) nga shitja e aktiveve afat-gjata	21 -	6,642,835
Humbje (fitim) nga shitja e investimeve	22 -	1,135,000
Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit para rregullimeve ne kapitalin punues	4,636,586	20,719,640
(Rritje) / ulje e llogarive te arketueshme dhe te tjera	95,246,632	(2,918,826)
(Rritje) / ulje e inventareve	161,375,693	(73,126,179)
Rritje /(ulje) ne furnitore dhe te tjera detyrime	(261,175,552)	47,339,498
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	1,205,128	(7,985,867)
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	(1,121,768)	(888,836)
Fluksi monetar neto nga veprimtarite e shfrytezimit	83,360	(8,874,703)
Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit		
Acquisition of property, plant, and equipments	8 (3,511,481)	(1,725,115)
Shitja e aktiveve të afat-gjata	21 -	4,550,028
Shitja e investimeve	22 -	126,000
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite e investimit	(3,511,481)	2,950,913
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Arketime (Pagesa) nga detyrime per abonete	-	(70,557,693)
Arketime (Pagesa) nga hua-marrja afatgjate	-	-
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (perdorur ne) veprimtarite financiare	-	(70,557,693)
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare	(3,428,121)	(76,481,482)
Mjete monetare me 1 Janar	40,690,944	117,172,426
Mjete monetare me 31 Dhjetor	3 37,262,823	40,690,944

***Shoqeria gjatë viti 2013 ka bere mbylljen e detyrimeve ndaj investitoreve me punime te procesit te apartamenteve tek rruga Jordan Misja.

Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2013
(në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

	Kapitali i Regjistruar	Rezerva te tjera	Fitimi i Akumuluar	Totali
Gjendja me 01 Janar, 2012	136,800,000	191,401,607	7,416,088	335,617,695
Fitimi i periudhes	-	-	5,630,023	5,630,023
Rritje (zvogelim) rezervash		(103,993,858)	(7,416,088)	(111,409,946)
Gjendja me 31 Dhjetor, 2012	136,800,000	87,407,749	5,630,023	229,837,772
Gjendja me 01 Janar, 2013	136,800,000	87,407,749	5,630,023	229,837,772
Fitimi i periudhes	-	-	2,338,737	2,338,737
Rritje (zvogelim) rezervash		(8,699,365)	(5,630,023)	(14,329,388)
Gjendja me 31 Dhjetor, 2013	136,800,000	78,708,384	2,338,737	217,847,121



Shenimet e pasqyrave financiare

1. Informacion i pergjithshem

Otto - AI sh.p.k (“Shoqeria”) është Shoqeri Anonime e krijuar me daten 23 Shkurt 1999. Selia e Shoqërisë është në Rruga Elbasanit, Prane Fakultetit Gjeologjik, Tiranë, Shqipëri. Shoqeria është regjistruar në autoritetet fiskale me Numer Identifikimi të Personit të Tatueshem (NIPT) J92009003W.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ndërtimi publik, punët civile, shfrytëzimet minerale, dhe transporti publik .

Administrator i Shoqërisë është Z. Isuf Berberi. Më 31 Dhjetor 2013 shoqeria kishte 10 punonjes (31 Dhjetor 2012: 9 punonjes).

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë me 25 Mars 2014.

2. Permbledhje e politikave të rëndësishme kontabel

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Shoqeria mban llogaritë e saj në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe standartet kombëtare të kontabilitetit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit që janë të përfshira në ligjin Nr 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin Nr 9477 datë 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit të Financave Nr 65 datë 5.05.2008 dhe në përputhje me politikën kontabel të grupit.

Keto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimësi.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë shprehur në Leke shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë. Disa riklasifikime janë bërë të nevojshme për vlerat krahasuese për të qenë konform prezantimit të vitit aktual.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuar janë si më poshtë:

Aktivët afatgjata materiale	Normat e zhvlerësimit %	
	2013	2012
Ndërtesa	5	5
Makineri dhe pajisje	20	20
Mobilje dhe orëndi	20	20
Pajisje elektronike	20	20

Vlera kontabel e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Në q.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabel tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivët ose njesitë gjeneruese të parës do të pakesohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.3 Aktivët dhe detyrimet financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare konsistojnë teresisht në llogari të arketueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumën e faturuar.

Provizionet për borxhet e keqija njihen kur shumën konsiderohen të pambledhshme. Provizionet për borxhet e keqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arketueshme ekzistuese që mund të behen të pambledhshme si pasoje e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qenesishme dhe të çilisise së klienteve dhe faktoreve të tjere relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (psh kliente të klasifikuar si të dyshimta dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arketueshme për atë klient si provizion për borxhet e keqija.

2.4 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arke në monedhe vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

2.5 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhe të huaj përkthehen në Leke dhe regjistrohen duke përdorur kursin zyrtar në datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe zërat e tjere jomonetare në bilanc të shprehur në monedhe të huaj janë përkthyer në Leke me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat e këmbimit që rezultojnë kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zerave të bilancit të shprehur në monedhe të huaj paraqiten si vijon (në Leke):

	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140.20	139.59
1 USD	101.86	105.85

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

2.1 Te ardhurat dhe shpenzimet

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do te hyjne ne shoqeri dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme

Njohja e të ardhurave për apartamentet e ndërtuara në Tiranë është bërë sipas SKK 08 “Të ardhurat”. Parapagimet e arkëtuara nga klientë regjistrohen si detyrime deri në momentin që arkëtohet plotësisht vlera e shitjes dhe bëhet kalimi i titullit të pronësisë. Gjatë fazës së ndërtimit Kompania ka njohur një normë fitimi minimale prej 7% në cdo situacion punimesh sikur kërkohet nga Legjislacioni Fiskal.

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave në momentin kur ato ndodhin. Shpenzimet që lidhen me apartamentet janë njohur si fillim si pune në proces dhe më pas shpenzohen në momentin e shitjes së apartamenteve dhe njohjes së te ardhurave.

2.6 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me legjislacionin shqiptar per tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne pasqyren e te ardhurave me perjashtim te zerave qe njihen direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera gjitheperفشيره.

Tatim mbi fitimin eshte tatim fitimi i pritshem mbi te ardhurat e tatueshme per vitin, duke perdorur normat e tatimit ne daten e raportimit, dhe cdo korigjim te tatimit te pagueshem per vitet e kaluara.

Tatim fitimi llogaritet me 10 % per vitin 2013 (31.12.12: 10%) mbi fitimin e tatueshem

2.7 Detyrime per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

2.8 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlere te drejte, minus koston e transaksionit te ndodhur. Huamarrjet njihen me vone me koston te amortizuar. Cdo diference ndermjet parave te marra (minus koston e transaksioneve) dhe vleres perfundimtare do te njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes duke perdorur metoden e interesit efektiv.

2.9 Raportimi i segmenteve

Nje segment eshte nje grup aktivesh i identifikueshem dhe aktiviteteve operative qe eshte i angazhuar per te siguruar produkte ose sherbime, subjekt i risqeve dhe shperblimeve qe jane ndryshe nga ato te segmenteve te tjere. Segmentet gjeografike sigurojne produkte dhe sherbime ne nje territor te percaktuar ekonomik dhe te ekspozuar ndaj risqeve te ndryshme nga ato te segmenteve te tjere gjeografike.

2.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palet e lidhura jane ato ku nje pale kontrollohet nga tjetra ose ka influence te rendesishme ne marrjen e vendimeve financiare ose te biznesit te pales tjetere.

3. Mjetet monetare

Mjetet monetare jane si vijon:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Arka		
- ne monedhe vendase	1,540,922	1,828,076
- ne monedhe te huaj	8,676,631	8,773,215
	10,217,553	10,601,292
Llogari rrjedhese ne banka		
- ne monedhe vendase	1,091,152	1,510,011
- ne monedhe te huaj	25,954,117	28,579,641
	27,045,269	30,089,653
Te tjera	-	-
Totali i mjeteve monetare	37,262,823	40,690,944

4. Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme perbehen nga balanca me kliente vendas.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Kliente pale te lidhura	46,885,168	47,494,417
Kliente te ndryshem	6,602,187	117,146,340
Minus provigjone per borxhin e keq	-	-
Llogari te arketueshme, neto	53,487,355	164,640,757

Drejtimi i Kompanise beson se risku i mosarketimit eshte minimal dhe nuk parashikohet borxh i keq.

5. Te tjera te drejta te arketueshme

Te tjera te arketueshme jane detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Marredhenie me pale te lidhura	73,929,532	71,237,590
Te drejta ndaj Investitorit Maks Caslli per Pall. J.Misja	13,342,150	-
Tatim fitimi i parapaguar	4,576,397	4,703,719
Te tjera	375,000	2,523,548
Shpenzime te periudhave te ardhshme	-	12,180,840
Totali	92,223,079	90,645,697

6. Inventari

Inventari eshte pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Apartamente te gatshme	198,407,797	-
Materiale te tjera	1,232,128	1,232,128
Materiale ndertimi	176,192	640,795
Totali	199,816,117	1,872,924

7. Punime ne proces

Punimet ne proces ne lidhjen me objektin tek Rruga Jordan Misja u mbyllen gjate vitit 2013 dhe iu kaluan investitoreve.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Punime në proces pallati J.Misja	-	339,846,637
Të tjera shpenzime	-	19,472,250
Totali	-	359,318,887

8. Aktivet afatgjata materiale

	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjetet e transportit	Paisje zyre	Total
Kosto					
Me 1 Janar 2013	51,029,636	6,571,105	27,999,288	4,104,734	89,704,763
Shtesat	3,479,056	-	-	32,425	3,511,481
Pakesimet	(6,618,096)	-	-	-	(6,618,096)
Me 31 Dhjetor 2013	47,890,596	6,571,105	27,999,288	4,137,159	86,598,148
Zhvleresimi					
Me 1 Janar 2013	(5,288,628)	(5,146,809)	(22,642,959)	(3,038,766)	(36,117,162)
Zhvleresimi i vitit	(728,530)	(284,859)	(1,071,266)	(213,194)	(2,297,849)
Pakesimet	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2013	(6,017,158)	(5,431,668)	(23,714,225)	(3,251,960)	(38,415,011)
Vlera neto kontabel 1 Janar 2013	45,741,008	1,424,296	5,356,329	1,065,968	53,587,601
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2013	41,873,438	1,139,437	4,285,063	885,199	48,183,137

	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Mjetet e transportit	Paisje zyre	Total
Kosto					
Me 1 Janar 2012	49,322,721	7,651,775	63,156,465	4,086,534	124,217,495
Shtesat	1,706,915	-	-	18,200	1,725,115
Pakesimet	-	(1,080,670)	(35,157,177)	-	(36,237,847)
Me 31 Dhjetor 2012	51,029,636	6,571,105	27,999,288	4,104,734	89,704,763
Zhvleresimi					
Me 1 Janar 2012	(2,927,001)	(5,318,608)	(43,898,898)	(2,827,627)	(54,972,134)
Zhvleresimi i vitit	(2,361,627)	(332,663)	(3,284,583)	(211,139)	(6,190,012)
Pakesimet	-	504,462	24,540,522	-	25,044,984
Me 31 Dhjetor 2012	(5,288,628)	(5,146,809)	(22,642,959)	(3,038,766)	(36,117,162)
Vlera neto kontabel 1 Janar 2012	46,395,720	2,333,167	19,257,567	1,258,907	69,245,361
Vlera neto kontabel 31 Dhjetor 2012	45,741,008	1,424,296	5,356,329	1,065,968	53,587,601

9. Investime ne shoqëri të tjera

Investimet ne shoqeri te tjera jane pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Investime te Fassa&Berberi Sh.A	5,200,000	5,200,000
Investime te Phoenix Petroleum Gas Sh.A	1,100,000	1,100,000
Totali	6,300,000	6,300,000

10. Furnitore

Furnitoret perfshijne kryesisht detyrimet kundrejt furnitoreve vendas.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Furnitore vendas	215,913,003	147,052,854
Furnitore te huaj	390,417	390,417
Furnitore neto	216,303,420	147,443,271

11. Paga të pagueshme dhe të ngjashme

Detyrimet për pagat dhe detyrime të ngjashme :

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Paga e shperblime	353,329	444,459
Sigurime shoqërore e shëndetsore	117,611	124,549
Totali i pagave të pagueshme dhe të ngjashme	470,940	569,008

12. Te tjera te pagueshme

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Detyrime te ndryshme	609,529	609,529
TVSH e pagueshme	2,001,801	104,567
Tatim mbi te ardhurat personale	39,700	84,800
Totali	2,651,030	798,896

13. Parapagime të marra nga klientët

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Parapagime Pallati J.Misja per investitoret	-	105,443,867
Te ardhura te shtyra (klering) J.Misja	-	130,332,389
Totali	-	235,776,256

14. Huamarrje afat gjatë

Huamarrjet afatgjate jane detajuar si meposhte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
<u>Huamarrje afat-gjate</u>		
Isuf Berberi	-	48,411,373
Maks Caslli	-	54,220,233
	-	102,631,606
Minus: pjesen afat-shkurter te kredise afat-gjate	-	-
Totali huamarrje afat-gjate	-	102,631,606

15. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Me 31 Dhjetor 2013 dhe 2012, sipas Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) totali i kapitalit te regjistruar eshte 136,800,000 Leke.

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012	%
Isuf Berberi	136,800,000	136,800,000	100
Totali	136,800,000	136,800,000	100

Rezerva te tjera

Balanca e rezerva te tjera eshte krijuar nga fitimi i pashperndare i viteve te meparshme dhe ne 31 Dhjetor 2013 eshte 78,708,384 Leke (2013: 93,037,772 Leke)

16. Te ardhura nga veprimtarite e shfrytezimit

Shoqeria ka vazhduar edhe gjate vitit 2013 te kryeje punime. Situacionet nga keto punime jane pasqyruar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Situacione punimesh e objektit J.Misja	24,292,815	64,529,012
Situacione punimesh godina Fufarma	4,594,651	7,384,942
Totali	28,887,466	71,913,954

17. Te ardhura te tjera

Te ardhurat e tjera jane detajuar si me poshte

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Te ardhura nga qeraja	12,492,238	10,680,370
Rikonstruksion zyrash	2,899,213	-
Te tjera	91,733	1,436,962
Te ardhura nga bileta dhe abone	-	30,726,750
Sherbime Konsulence	-	1,397,000
Totali	15,483,184	44,241,082

18. Kostoja e materialeve te konsumuara

Kostoja e materialeve eshte detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Gendja ne fillim	1,872,924	6,181,560
Shpenzime blerje materiale e produkte	201,341,960	9,306,593
Transport	17,100	167,972
Gendja ne fund	-199,816,117	-1,872,924
Kostoja e materialeve	3,415,866	13,783,201
Blerje te tjera (goma, pjese kembimi etj)	-	16,585,532
Bileta dhe abone	-	480,596
Situacione punimesh	22,775,644	41,392,316
Totali	26,191,511	72,241,645

19. Shpenzime personeli

Shpenzimet per personelin perfshijne si vijon:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Paga dhe shperblime	6,134,000	11,616,590
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	891,080	1,716,211
Totali	7,025,080	13,332,801

20. Shpenzime administrative dhe te tjera

Shpenzimet administrative dhe te tjera perbehen nga:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Ruajtje objekti	1,351,000	2,070,000
Sherbime Profesionale	1,246,809	773,733
Penalitete dhe gjoba	1,190,183	-
Telekomunikacion	728,774	785,621
Taksa nacionale dhe lokale	480,660	2,222,351
Energji, uje	424,479	411,714
Kanceleri	325,770	440,127
Te tjera	256,707	1,976,111
Sherbim bankare	66,592	44,131
Mirembajtje dhe riparime	58,503	213,909
Siguracion	12,000	
Qera	-	232,307
Totali	6,141,477	10,060,004

21. Te ardhura (humbje) nga shitje e asetëve

Të ardhurat e nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale janë detajuar si më:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vlera e shitjes se automjeteve	-	4,753,200
Vlera kontabile bruto e automjeteve	-	-11,192,863
Difference nga vlera e mbetur vlera skrap	-	-203,172
Totali	-	-6,642,835

22. Te ardhura (humbje) nga shitje e investimeve

Të ardhurat e nga shitja e investimeve janë detajuar si më:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Vlera e shitjes se investimeve	-	126,000
Vlera kontabile e investimeve	-	-1,261,000
Totali	-	-1,135,000

23. Te ardhurat/(shpenzimet) financiare

Te ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo te përealizuara nga kurset e kembimit, te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe te tjera te ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Fitime (humbje) nga kurset e kembimit	(389)	26,462
Fitime (humbjet) neto nga kurset e kembimit	(389)	26,462
Te ardhura (shpenzime) financiare	17,569	172,592
Te ardhurat (shpenzimet) neto financiare	17,569	172,592
Totali i te ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	17,180	199,054

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit rakordon me fitimin kontabël per vitin 2013 dhe 2012 si me poshte:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
1 Fitimi/(Humbja) para tatimit	2,731,936	6,751,793
2 Shpenzime te panjohura	9,874	351,211
3 Gjoha e penalitete	1,190,183	434,094
4 Vlera kontabile e asetëve te shitura	-	3,680,603
Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3+4)	3,931,993	11,217,701
5 Humbje te mbartura (-)	-	-
6 Fitimi i tatueshem	3,931,993	11,217,701
Norma e tatimit mbi fitimin	10%	10%
7 Shpenzim tatim fitimi	393,199	1,121,770
8 Tatim fitimi i parapaguar	4,969,596	5,825,489
9 Tatim fitimi i arketueshem (i pagueshem)	4,576,397	4,703,719

25. Gjykimet dhe cmuarjet e rendesishme kontabel

Ne aplikimin e politikave kontabel te Kompanise, qe pershkruhen ne Shenimin nr 2, drejtimin i kerkohet qe te beje gjykime, cmuarje, dhe supozime per vleren kontabel te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk jane te qartesisht te dukshme nga burime te tjera. Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto cmuarje.

Cmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme. Ndryshimet ne cmuarjet kontabel do te njihen ne periudhen ne te cilen cmuarja eshte rishikuar nqs rishikimi ndikon vetem ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudha te ardhshme nqs rishikimi ndikon periudhen aktuale dhe ato te ardhme.

Pasiguria ne gjykime

Zhvleresimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvleresimi do te njihen ne vleren ne te cilen vlere kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlere e rikuperueshme, drejtimi vlereson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njesi gjeneruese e parase dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlere aktuale e ketyre flukseve te parase.

Zhvleresimi i aktiveve financiare

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme

Kompania llogarit zhvleresimin per llogarite e arketueshme bazuar ne humbjet e vleresuara qe rezultojne nga paaftesia e klienteve per te bere pagesat e kerkuara. Vleresimi i mjaftueshmerise se humbjes nga zhvleresimi per llogarite e dyshimta eshte bazuar ne analizen e vjetersise te llogarive te arketueshme dhe eksperiencen historike te cregjistrimit, cilesine e klientit dhe ndryshimet ne termat e pageses se klientit. Kjo perfshin supozime per sjelljen e ardhshme te klientit dhe mbledhjet e ardhshme te parave. Nqs kushtet financiare te klientit perkeqsohen, eliminimet aktuale te llogarive te arketueshme ekzistuese mund te jene me te larta se sa priteshin dhe mund te kalojne nivelin e humbjeve nga zhvleresimi te njohura deri tani.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon ne menyre te vazhdueshme jeten e dobishme te aktiveve te mbajtura me kosto te amortizuar ne cdo date te pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlereson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmerine e pritur te ketyre aktiveve. Vlere e mbetur e ketyre aktiveve eshte analizuar ne Shenimin 7. Rezultatet reale mund te ndryshojne per shkak te konsumimit teknologjik.

Inventari

Inventari eshte paraqitur me vleren me te ulet midis koston dhe vleres se realizueshme neto. Gjate percaktimit te vleres se realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive te disponueshme per kryerjen e vleresimeve.

26. Angazhimet dhe detyrime te kushtezuara

Angazhime

Shoqeria nuk ka angazhime materiale te nenkontraktuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar te cilat te mos jene reflektuar ne pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe te dhenat kontabel per vitet financiare qe perfundojne me 31 Dhjetor 2013 nuk jane audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore te Shoqerise mund te mos konsiderohen te finalizuara.

Ceshtje gjyqesore

Ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare 31 Dhjetor 2013, nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te ngritur kunder Shoqerise.

27. Ngjarje pas dates se raportimit

Me daten 20 Shkurt 2014 është bërë shitje e aksioneve të Phoenix Petroleum Gas sh.a , Z. Isuf Berberi.

